



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET E RISKUT NË PUNË
Tema 2.6.	RREZIQET QË LIDHEN ME AKSIDENTET NË PUNË
Nën-tema 2.6.6.	RRËSHQITJET, PENGIMET DHE RËNIET NË VENDET E PUNËS
Ligji / rregulloret përkatëse:	<ul style="list-style-type: none">• Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë;• Rregullore (MPMS) Nr.01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës ;• Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë.
Shkurtesa:	<ul style="list-style-type: none">• MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Fushëveprimi i listës kontrolluese:	Kjo listë kontrolluese është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushëveprimin e zbatimit të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe bazat mbi të cilat kryhen puna ose trajnimi në vendet e punës ku ekziston rreziku për shëndetin, veçanërisht për rrëshqitje, pengime dhe rënie që çojnë në aksidente në punë.
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	INSPEKTIMI I RREZIQEVE PËR RRËSHQITJE, PENGIME DHE RËNIE NË VENDET E PUNËS			
	<i>* Bëhuni shembull; respektoni rregulloret e sigurisë dhe shëndetit në lokacionin / vendet e punës të inspektuara!</i> <i>* Gjatë vizitës në lokacion/vendin e punës kushtoni vëmendje aspekteve të përgjithshme ose organizimit të punës dhe proceseve, duke përfshirë paraqitjen e vendeve të punës dhe mjedisit rrethues, duke përfshirë cilësinë e</i>			


	<p><i>dyschemesë, ndriçimin dhe mikroklimën që mund të kenë efekt në rreziqet për rrëshqitje, pengime dhe rënie.</i></p> <p><i>* Merrni shënime për vendet e vëzhguara të punës dhe bëni fotografi të vendeve të punës dhe rrethinës (kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë).</i></p> <p><i>* Mbani mend:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>○ kushtojini vëmendje mirëmbajtjes së vendeve të punës (p.sh., pastrimi i lëngjeve të derdhura etj.);</i> <i>○ pyesni disa prej të punësuarve tuaj në lidhje me informacionin e tyre në lidhje me rreziqet dhe masat parandaluese për të shmangur rrëshqitjet, pengimet dhe rëniet.</i> <p><i>* Nëse keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspertin tuaj për SSHP, takohuni me të/ata.</i></p> <p><i>* Ftoni përfaqësuesin e të punësuarve të marrë pjesë në kontrollimin e dokumenteve.</i></p>			
1.	<p>A është kryer vlerësimi i riskut për rreziqet nga rrëshqitjet, pengimet dhe rëniet në vendet e punës?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Është obligim i juaji të siguron vlerësimin e riskut - kontrolloni nëse është kryer dhe dokumentuar.</i> ● <i>Kontrolloni nëse vlerësimi i riskut përmban analiza të rreziqeve që lidhen posaçërisht me rrëshqitjet, pengimet dhe rëniet.</i> ● <i>Kontrolloni nëse janë marrë masat e nevojshme për t'i shmangur ose zvogëluar këto risqe (p.sh. masat e marra organizative ose teknike).</i> 			
2.	<p>A është ofruar informacion dhe trajnim i mjaftueshëm për të punësuarit në lidhje me rreziqet për rrëshqitje, pengime dhe rënie, si dhe masat e mundshme parandaluese?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Nenet 7, 9, 13, 20</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>A ka informacion (të shkruar) në dispozicion dhe të ofruar për të punësuarit (p.sh. materiale, trajnimi, broshura/postera)?</i> 			

	<ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse informacioni specifik për trajnim (nëse aplikohet) përfshin:</i> <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>rreziqet specifike për rrëshqitje, pengime dhe rënie, informacionet mbi vendet e veçanta ku mund të ndodhin këto rreziqe.</i> ● <i>Kontrolloni nëse të punësuarve u janë ofruar trajnime formale?</i> ● <i>A është përsëritur periodikisht sipas kërkesave ligjore dhe/ose në rastet kur kanë ndryshuar vendet e punës ose procedurat?</i> 			
3.	<p>A ka pasur konsultime me të punësuarit (dhe përfaqësuesit e tyre) në lidhje me rreziqet për rrëshqitje, pengime dhe rënie?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 19</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>A kanë qenë të përfshirë të punësuarit (dhe/ose përfaqësuesit e tyre) në vlerësimin e risqeve për rrëshqitje, pengime dhe rënie, si dhe planifikimin e masave parandaluese (p.sh. politikat organizative, orari i mirëmbajtjes, trajnimet për të punësuarit, konsultimet etj.).</i> 			
4.	<p>A përcaktohen dhe sigurohen orare të rregullta të mirëmbajtjes për të ofruar pastërtinë dhe rregullin e duhur?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 5</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Është obligim i juaji të siguroni kushte të sigurt dhe të shëndetshme të punës në të gjitha aspektet e punës.</i> ● <i>Kontrolloni nëse oraret e mirëmbajtjes dhe pastrimit mbulojnë pastrimin e rregullt dhe në kohë të dyshemeve dhe shkallëve duke përfshirë largimin e pluhurit, lëngjeve të derdhura, materialeve të shpërndara, mbeturinave etj.</i> ● <i>Kontrolloni nëse materialet dhe mjetet pastruese ruhen siç duhet.</i> ● <i>Kontrolloni nëse procedurat e pastrimit përfshijnë pastrimin e menjëhershëm të lëngjeve të derdhura, vendosjen e shenjave që shënojnë zona të rrëshqitshme.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka vende të përshtatshme për grumbullimin e mbeturinave/mbetjeve (p.sh. shportat e mbeturinave, ambiente të veçanta për ruajtjen e vajrave të derdhur ose materialeve të tjera të rrezikshme, etj.).</i> 			

	<p>Grupi tjetër i pyetjeve analizon rreziqet e mundshme për rrëshqitje, pengime dhe rënie. Ju lutemi përgjigjuni secilës prej pyetjeve dhe kontrolloni nëse janë konsideruar këto aspekte në vlerësimin e riskut dhe nëse ka masa parandaluese të zbatuara në praktikë.</p>			
5.	<p>A janë dyshemetë në zonat e punës dhe në vendkalime të niveluara, të pastra dhe të përshtatshme për ecje dhe lëvizje të sigurt?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse dyshemetë janë të rrafshëta, pa rreziqe nga rrëshqitja, pengimi dhe rënia, si dhe a mbahen në rregull (p.sh., pa pllaka të dëmtuara, tepiha të vjetruar etj.).</i> ● <i>Kontrolloni nëse dyshemetë nuk kanë tepiha, shtroja, pllaka dhe dërrasa të lirshme.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka shtrojë ose dysheme kundër rrëshqitjes, të përdorura në vendet ku mund të derdhen ujë ose materiale të tjera?</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka ndryshime në nivelin e dyshemesë ose sipërfaqeve të punës, vrima, kablo të shpërndara dhe sende në dysheme.</i> 			
6.	<p>A janë shkallët e pastra dhe të përshtatshme për ecje dhe lëvizje të sigurt?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse shkallët janë të pastra, pa sende të shpërndara dhe pluhur.</i> ● <i>Kontrolloni nëse shkallët janë me lartësi të barabartë (të ngjashme), me sipërfaqe rezistente ndaj rrëshqitjes të mbajtura në rregull.</i> ● <i>Kontrolloni nëse parrakët janë të vendosur, të qëndrueshëm dhe të sigurt.</i> 			
7.	<p>A janë sipërfaqet në vendet e jashtme të punës të rrafshëta, të pastra dhe të përshtatshme për ecje dhe lëvizje të sigurt?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse sipërfaqet e jashtme (p.sh., vendet e parkimit, vendkalimet, vendet e ngarkimit etj.) janë të rrafshëta, pa rreziqe për rrëshqitje, pengime dhe rënie dhe mbahen në rregull (p.sh. pa vrima ose çarje) dhe pa bimësi (p.sh. myshk).</i> 			

	<ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse sipërfaqet janë pa yndyrë, mbeturina dhe vajra të derdhur, dëborë dhe akull (nëse ka).</i> 			
8.	<p>A janë rampat në vendet e punës jo shumë të pjerrëta, të pastra dhe të përshtatshme për ecje dhe lëvizje të sigurt?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse rampat (p.sh., për ngritjen e platformave etj.) janë shumë të pjerrëta.</i> ● <i>Kontrolloni nëse rampat janë bërë nga materiale të rrëshqitshme (p.sh. çeliku, druri i rrëshqitshëm, betoni i lyster) dhe a kanë teksturë të mjaftueshme të këmbës.</i> ● <i>Kontrolloni nëse rampat kanë parrakë të qëndrueshëm dhe, nëse përdoren karroca, “binarë” për të parandaluar rrokullisjen nga rampat.</i> 			
9.	<p>A ruhen si duhet pajisjet dhe materialet?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse pajisjet (p.sh., makineritë, mjetet, pajisjet e pastrimit, karrocet etj.) ruhen në korridore ose vendkalime ose afër dyerve.</i> ● <i>Kontrolloni nëse mallrat (lëndët e para dhe/ose produkti i gatshëm ose paletat e zbrazëta) ruhen në korridore ose vendkalime ose afër dyerve</i> ● <i>Kontrolloni nëse sendet personale (p.sh., çantat e dorës, çantat e shpinës etj.) ruhen në korridore ose vendkalime ose afër dyerve.</i> 			
10.	<p>A kërkohet nga punëtorët që të kërcëjnë ose të zbresin/ngriten në nivele të ndryshme?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse punëtorëve u kërkohet të zbresin / kërcëjnë poshtë në nivele më të ulëta (p.sh. rampa, podiume etj.).</i> 			

	<ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse punëtorët mund të ngjiten në mënyrë të sigurt nga kabinat e kamionëve, pirunarëve, pajisjeve lëvizëse të pastrimit (a janë të pajisur me mbajtës të duhur, shkallë jo të rrëshqitshme etj.).</i> 			
11.	<p>A ka ndriçim të mjaftueshëm në zonat e punës, kalimet dhe shkallët?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Tabela 2</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse të gjitha zonat e punës, kalimet dhe shkallët kanë nivele të mjaftueshme të ndriçimit (qoftë natyral dhe/ose artificial) dhe sistemet e ndriçimit mbahen në rregull.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka sistem ndriçimi emergjent (rezervë) dhe nëse është testuar dhe mirëmbajtur.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka procedurë për zëvendësimin e shpejtë të llambave të djegura.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka ndryshime të papritura në nivelet e ndriçimit (p.sh., midis dyerve dhe shkallëve ose zonave të ngarkimit).</i> 			
12.	<p>A ka derdhje të lëngjeve në dysheme në zonat e punës ose në vendkalime?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse ka zona me derdhje të dukshme të lëngjeve (p.sh. pikimi i ujit, rrjedhjet e vajit nga makineritë, produktet e derdhura, zonat e ushqimit etj.).</i> ● <i>Kontrolloni nëse janë vendosur masa teknike të përshtatshme dhe efektive (p.sh., panelet e kullimit ose mbrojtëse të vendosura, etj.).</i> ● <i>Kontrolloni nëse janë vendosur masa organizative të përshtatshme dhe efektive (p.sh., procedura për pastrimin e shpejtë etj.) dhe shenjat e sigurisë.</i> 			
13.	<p>A janë veshjet dhe këpucët e përdorura nga të punësuarit të përshtatshme që të mos shkaktojnë rrëshqitje, pengime dhe rënie?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse punonjësit kanë veshje që mund të shkaktojnë pengime (p.sh., shumë të mëdha, shumë të trasha, shumë të gjata, etj.).</i> 			

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Kontrolloni nëse këpucët e veshura nga të punësuarit janë kundër rrëshqitjes dhe të sigurta (p.sh. nuk kanë taka të larta etj.).</i> 		
14.	<p>A ka numër të mjaftueshëm të shenjave paralajmëruese të vendosura në zonat ku rrëshqitjet, pengimet dhe rëniet janë të mundshme?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kontrolloni nëse zonat e punës dhe vendkalimet ku pengimet dhe rëniet janë të mundshme, janë të shënuara qartë (duken nga distanca kur afroheni, në lartësinë e duhur) me shenjat “Pengesa” dhe “Rënie”.</i> <div style="text-align: center;">  <p>“Pengesa” “Rënie”</p> </div>		
15.	<p>A janë tepër të mëdha/voluminoze ngarkesat/artikujt që duhet të mbahen?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kontrolloni se mos madhësia e ngarkesave/artikujve është shumë e madhe - p.sh., duke mos penguar pamjen e qartë të vendkalimeve ose duke shkaktuar ekuilibër të dobët, etj.</i> 		